



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORË
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

Nr. 11 Prot

Datë, 11.03.2020

NJOFTIM

**PËR HAPJEN E PROCESIT TË REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE PËR REKTOR
DHE ANËTAR TË SENATIT AKADEMIK NË UNIVERSITETIN “ISMAIL QEMALI”
VLORË**

Në zbatim të Ligjit Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Senatit Akademik Nr.59, datë 11.02.2020 “Për miratimin e Rregullores për organizmin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë, neni 25, Vendimit të Komisionit Institucional Zgjedhor Nr.4, datë 11.03.2020 “Për hapjen e procesit të regjistrimit të kandidatëve për Rektor dhe Anëtar të Senatit Akademik në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë”, Komisioni Institucional Zgjedhor, hap procesin e regjistrimit të kandidatëve për Rektor dhe Anëtar të Senatit Akademik. Kërkesa për kandidim nga personat e interesuar depozitohet nga kandidati në Sallën e Mbledhjeve të Senatit, kati i tretë, godina A, nga data 24.03.2020, deri në datën 28.03.2020, brenda orarit zyrtar 8:00-16:00.

I - Kandidatët për Rektor duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

a).Kërkesa për kandidim, përmban:

- 1.Emrin;
- 2.Atësinë;
- 3.Mbiemrin;
- 4.Datëlindjen;
- 5.Gjininë;
- 6.Kopje të dokumentit të identifikimit;
- 7.Shprehjen e vullnetit për kandidim;
- 8.Formularët e vetëdeklarimit, të cilët kandidati i tërheq pranë KIZ-it;
- 9.Deklarimin se kandidati nuk ka fituar dy mandate sipas ligjit nr.9741, datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në RSH”, si autoritet drejtues në postin për të cilin kërkon të kandidojë në të njëjtin institucion;
10. Deklarimin e mungesës së plagjiaturës në punimet për fitimin e gradës shkencore dhe titullit akademik;
- 11.Deklarimin se nuk ka shkak për të qenë objekt i ligjit 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;
- 12.Deklarimin që nuk është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale.
- 13.Deklarimin për neutralitetin politik, mosqenien pjesë e forumeve të larta politike në vend.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

II - Kandidatët për anëtar të Senatit Akademik duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

a).Kërkesa për kandidim, përmban:

- 1.Emrin;
- 2.Atësinë;
- 3.Mbiemrin;
- 4.Datëlindjen;
- 5.Gjininë;
- 6.Kopje të dokumentit të identifikimit;
- 7.Shprehjen e vullnetit për kandidim;
- 8.Formularët e vetëdeklarimit, të cilët kandidati i tërheq pranë KIZ-it;
- 9.Mungesen e plagjiaturës në punimet për fitimin e gradës shkencore dhe titullit akademik;
- 10.Deklarimin se nuk ka shkak për të qenë objekt i ligjit 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;
- 11.Deklarimin që nuk është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale.
- 12.Deklarimin për neutralitetin politik, mosqenien pjesë e forumeve të larta politike në vend.

III - Kandidatët për anëtar të Senatit Akademik nga radhët e studentëve duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kërkesën për kandidim, e cila përfshin, emrin atësinë, mbiemrin, datëlindjen, gjininë dhe shprehjen e vullnetit për kandidim;
2. Kopje të dokumentit të identifikimit;
3. Vërtetimin që provon se është student me kohë të plotë në një nga njësitë kryesore të UV-së;
4. Propozimin nga jo më pak se 30 (tridhjetë) studentë, pjesë e trupës zgjedhore, sipas standardeve të parashikuara në Rregullore, të cilët krahas emrit, mbiemrit dhe nënshkrimit, vendosin në shkresën e propozimit edhe numrin personal të kartës së identitetit.
5. Dokumentin që vërteton mesataren e notës mbi bazën e provimeve të dhëna deri në momentin e kandidimit.

Kryetar i Komisionit Institucional Zgjedhor
Oljana Hoxhaj

Anëtarët
Shkelqim Sinanaj
Eljona Zanaj
Evis Allushi
Kristi Mucollari